

në **Morinë/Morina**. Pjesëtarët e forcave serbe i kanë varrosur kufomat e tyre në varrezat e qytetit në Gjakovë/Đakovica. Pas përfundimit të luftës, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tyre mortore në Varrëzat e Dëshmorëve të Luftës.

**Burimet:** H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 213, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Nenad (Aleksandar) Remištar

(4.02.1969, serb nga fshati Binxhë/Biča, komuna e Klinës/Klina, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Serbisë)

Nenadi punonte si pjesëtar i policisë rrugore në SPB-në e Gjakovës/Đakovica. Me familjen e vet jetonte në fshatin Binxhë/Biča. Në datën 13.06.1998, u nis në punë me automobilin e vet të tipit *Opel Kadet*, të ngjyrës gri metalik, me targat e Gjakovës/Đakovica. Me të në veturë ishte edhe një shqiptar i besimit katolik. Ngase nuk u kthye në shtëpi atë ditë, bashkëshortja e tij mendonte se ai sërish kishte shkuar në terren. Dhjetë ditë më vonë, babai i Nenadit ka dëgjuar nga një shqiptar i paidentifikuar se Nenadin dhe bashkudhëtarin e tij i kishin rrëmbyer në rrugën Klinë/Klina – Gjakovë/Đakovica. Në rrugë gjendej një pengesë e ngritur nga gurët. Nenadi e kishte ndalur makinën dhe ka dal nga ajo për ta hequr pengesën. Në ato çaste ia bëhen disa ushtarë të UÇK-së. E morën me vete Nenadin dhe bashkudhëtarin e tij, ua vuan maskat në kokë dhe i çuan në shtabin e UÇK-së në **Jabllanicë/Jablanica**. Atë ditë, pjesëtarët e UÇK-së e kanë rrahur Nenadin me shkop bejsbolli dhe gjësende të tjera të forta. Nuk mundte të lëvizte nga dëmtimet e shkaktuara. Një ditë më vonë, më **14.06.1998**, dy pjesëtarë të UÇK-së e çuan Nenadin jashtë shtabit dhe, nga ajo ditë, nuk ka asnjë gjurmë për të. Shqiptarin katolik e liruan. Familjarët janë ende duke kërkuar ndriçimin e fatit të Nenadit. Në evidencën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Nenadit është regjistruar në lëndën me numër YUK-050025-01.

**Burimet:** deklarata S.R, FDH-29090; deklarata A.R, FDH-5948; ICTY, IT-04-84 (R. Haradinaj

dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdalReforma&int\\_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\); KNK-K, Persona të zhdukur...](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdalReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-); KNK-K, Persona të zhdukur...), FDH-9795; *Nenada kidnapovali, život im zagorčali*, Oteta istina num.3, prill-qershor 2005, 28, FDH-19937; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 362.

## Dragan (Borislav) Stamenković

(3.11.1964, serb nga Çeçina, komuna e Dolevacit, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dragani e kishte mbaruar shkollën tregtare. Një kohë të shkurtër punonte në *EI Niš*. Më pas, e vijoi trajnimin për oficer police dhe, në muajin nëntor të vitit 1992, filloi nga puna në SPB-në e Dolevacit. Jetonte me bashkëshorten Draganen, vajzën Jovanen, babanë Borislavin dhe nënën Desanken në Çeçina. Dragani shkoi në Kosovë më 10.05.1998. Në mëngjesin e datës **14.06.1998**, në ora 03:20, e kanë qëlluar me pushkë snajperi, përderisa me bashkëluftëtarin Keki gjendej në njërën nga istikamet përreth fshatit **Rakovinë/Rakovina**. U varros në varrezat e Çeçinës më 16.06.1998.

**Burimet:** deklarata B.S, FDH-25848; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 64; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; *Dnevnik od 9. do 16. juna*, Ilustrovana politika, FDH-30378; SMIP, *Teroristički...*, III, 933-934; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-30479; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

## Adem (Bajram) Selmani

(1.07.1967, shqiptar nga Tropoja [Shqipëri], pjesëtar i UÇK-së)

Ademi punonte në policinë e qytetit të Tropojës [Shqipëri] nga viti 1994 deri në vitin 1997. U bë anëtar i UÇK-së në muajin prill të vitit 1998. Në shtëpinë e tij, pjesëtarët e UÇK-së përgatiteshin për ta kaluar matanë kufirit. Në datën **16.06.1998**, Ademi u nis me një grup luftëtarësh të UÇK-së, i cili e barte një dërgesë armësh nga Shqipëria në Kosovë. Ranë në pritë të forcave serbe te vendi i quajtur *Lugina e Rrasës/Poploçana dolina* [**Koshare/Košare**]. Gjatë përlshjes së armatosur që pasoi, Ademi e qëlluan për vdekje.